



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.644/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Arbenita Halilaj kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën, me seli në Prishtinë, për mungesë së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.11.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Pranohet** pjesërisht si e bazuar ankesa e Arbenita Halilaj kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën, me seli në Prishtinë.

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtare të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga subjekti politik Nisma për Kosovën, në Vendvotimet: 1960e/02r, 1921e/01r, 1921e/03r, 1921e/05d, 1921x/01r dhe 1921x/03r.

**III. Refuzohet si e pa bazuar** ankesa e Arbenita Halilaj kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën, sa i përket vendvotimeve: 1960e/01r, 1921x/02r, 1921x/04r, 1921e/04r, 1920/03r, 1920/04r, 1920/05r, 1920/06D dhe 1960e/003.

## A r s y e t i m

Me datën 09.11.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Arbenita Halilaj, me të cilën thekson se i mungojnë votat në këto vendvotime: në shkollën fillore “Nexhmi Mustafa” Prugoc, në klasët: 1960e/01r, 1960e/02r dhe 1960e/003; në shkollën fillore “Zenel Hajdini”, në klasët: 1920/03r, 1920/04r, 1920/05r, 1920/06D; në shkollën fillore “Asim Vokshi”, në klasët: 1921e/01r, 1921e/03r, 1921e/04r dhe 1921e/05d; në shkollën fillore “Emin Duraku”, në klasët 1921x/01r, 1921x/02r, 1921x/03r dhe 1921x/04r.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është pjesërisht e bazuar**

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të

Rezultatit, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për kandidaten Arbenita Halilaj nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën, në këto vendvotime: 1960e/02r, 1921e/01r, 1921e/03r, 1921e/05d, 1921x/01r dhe 1921x/03r dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekur, si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Lidhur me pjesën e refuzuar të ankesës të vendosur si në pikën III të këtij vendimi, paneli gjeti se pretendimet e ankueses janë të pa bazuara, sepse KQZ me vendimin nr. 2146/2017 të datës 01.11.2017, ka rinumëruar vendvotimet me numër: 1960e/01r, 1921e/04r, 1921x/02r, 1921x/04r, ndërsa sa i përket vendvotimeve me numër 1920/03r, 1920/04r, 1920/05r, 1920/06D dhe 1960e/003, paneli gjeti se nuk është specifikuar numri i vendvotimeve se ku janë bërë parregullsitë.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

ZL. Anr.644/2017 më datën 10.11.2017.



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.